



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



Komuna e Gjilanit
Opština Gnjilane
Municipal Gjilan
Gilan Belediyesi

DREJTORIA E ARSIMIT

05 nr 637/2012
Datë : 12.09/2012

Në bazë të nenit 4.1 dhe nenit 5 pika c dhe d të Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, Ligjit, Nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, si dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ 3/2009 për procedurat e zgjedhjes së drejtorëve të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese, Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan, shpall :

K O N K U R S **PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË LIRË TË PUNËS**

Institucioni : Konvikti i nxënësve dhe të studentëve
Pozita : Drejtor

Përshkrimi i punëve : Udhëheqë institucionin dhe është përgjegjës për :

- Zbatimin e ligjshmërisë,
- detyrat e caktuara për zgjedhjen, vlerësimin, disiplinën dhe çështjet e tjera që kanë të bëjnë me konviktin dhe punëtorë e tjerë të këtij institucioni,
- Planifikimin,udhëheqjen dhe koordinimin e të gjitha aktiviteteve në këtë Institucion,
- Zhvillimin e një plani afatmesëm dhe aftëgjatë për aktivitetin e Institucionit,
- Çështjet e tjera që rregullohen përmes ligjeve dhe akteve nënligjore sa i përket këtij institucioni.

Kushtet :

- Të jenë shtetas i Republikës së Kosovës,
- Të kenë të kryer njërin nga fakultetet përkatëse të licencuara të Universitetit të Prishtinës ose të fakulteteve private të akredituara dhe të licencuara nga MASHT,
- Të kenë më së paku 3 (tri) vite përvojë pune në arsim.

Dokumentet e nevojshme: Certifikata e lindjes, diploma e fakultetit të kryer, kopja e letërnjoftimit, dëshmia për përvojën e punës, CV-në sipas modelit të MASHI-it, Certifikatat e trajnimeve të zhvilluara, programin zhvillimor të Institucionit për të cilin ka konkurruar (në më së shumti pesë faqe tekst me 30 rreshta të letres të formatit A4), rekomandimin nga një person apo institucion publik-kredibil si dhe Certifikatën shëndetësore me të cilën dëshmohet gjendja shëndetësore. Dokumentacioni i kandidatëve të cilët nuk i plotësojnë kushtet e konkursit nuk do të shqyrtohet, ndërsa në intervistë do të ftohen vetëm kandidatët nga lista e ngushtë.

Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet jashtë Shtetit të Republikës së Kosovës si dhe nëpër kolegjet private brenda Republikës së Kosovës, e që konkurrojnë për këto vende të punës, duhen që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në pajtim me udhëzimin administrativ, nr. 8/2010 të datës 22.06.2010, në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kusht të konkursit.

Koeficienti është 8.4 .

Kohëzgjatja e kontratës: sipas udhëzimit administrativ 3/2009

Konkursi mbetet i hapur për aplikim 15 ditë nga dita e shpalljes në gazeta zyrtare.

Të gjithë kandidatët e interesuar duhet t'i marrin aplikacionet dhe të plotësuara të dorëzohen pranë Qendrës për Shërbim të Qytetarëve në Gjilan.

Drejtori

Bujar Nevzati